



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 42-17/2018 (JR)
Nr. 42-17/2018/5 regj.

Tiranë më 19.02.2024

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se sot, më datë 19.02.2024, në seancën e thirrur në orën 10.00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me nr. regjistri (JR) 42-17/2018, datë 11.04.2023, lidhur me kërkesën e ish-subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (JR) nr. 6, datë 28.02.2019, vendosi kalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e kërkueses, znj. Antoneta Sevdari dhe Institucionit të Komisionerëve Publikë, ditën e **hënë, në datën 11.03.2024, ora 10:00.**

Kolegji i Posaçëm i Apelit e mori këtë vendim në kuadër të ofrimit të garancive për një proces të rregullt ligjor, bazuar në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për t’i dhënë mundësinë Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe kërkueses, znj. Antoneta Sevdari, të dëgjohen dhe të mbajnë qëndrimet e tyre lidhur me kërkesën për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (JR) nr. 6, datë 28.02.2019.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese
Relator
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtare

Natasha Mulaj
Sokol Çomo
Ina Rama
Rezarta Schuetz
Albana Shtylla



Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE**

NATASHA MULAJ

